

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1120 Prot.Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 123, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit", - subjekti Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjetës Kanalizimeve"* Durrës, realizuar nga shoqëri e licencuar licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k. dhe individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit-subjekti Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjetës Kanalizimeve"* Durrës, realizuar nga shoqëri e licencuar licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k. dhe individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova.
2. Shoqëria e licencuar në arkeologji në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë, të paraqesë në KKA e radhës, konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit për traktin Nr. 6, i cili pozicionohet në zonën arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit dhe konceptin e sondazheve arkeologjike për Traktet Nr. 2, Nr. 4 dhe Nr. 12, të cilat pozicionohen në zonën arkeologjike "B" të tij.
3. Pas miratimit të konceptit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit për traktin Nr. 6, do të realizohet ky gërmim nga shoqëria e licencuar në arkeologji dhe Instituti i Arkeologjisë, duke lidhur paraprakisht aktmarrëveshje disa palëshe ndërmjet Investitorit, Institutit të Arkeologjisë, Shoqërisë së licencuar në arkeologji dhe ASHA, e cila do të mbikëqyrë atë.
4. Investitori, për të gjithë zonën e përfshirë në të traktet e tjera, për projektin "Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqërinë e licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për këto trakte, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.

5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjeve të sipërpërmendura.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO